

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:** **PAKR 161/16**  
**Më:** **15 shtator 2016**  
**Gjykata Themelore e Mitrovicës:** **P. Nr. 122/2014**

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Abdullah Ahmeti dhe gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov, anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Vjollca Kroci-Gerxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it, procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të akuzuarit:

**B. J., (me nofkën ‘xxx’), i lindur më xxx në xxx, xxx i Kosovës, emri i babait xxx, emri i nënës xxx;**

*I akuzuar* me Aktakuzën PP 363/2012 të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, të datës 10 tetor 2014, e cila është ngritur të njëjtën ditë në gjykatë, si dhe me Aktakuzën e ndryshuar të datës 12 nëntor 2014, të ngritur në gjykatë më 13 nëntor 2014. Kjo aktakuzë e ngarkon të akuzuarin (si dhe 7 të pandehur të tjerë) me këto vepra penale:

- **Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to**, në kundërshtim me nenin 142, par. (3) (6.2.i) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), lidhur me nenin 23 të KPK-së, aktualisht të dënueshme me nenin 174, par. (3) dhe (6.2.1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kuptim të nenit 31 të KPRK-së (Pika B.1),
- **Pengim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare**, në kundërshtim me nenin 316, par. (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, aktualisht të dënueshme me nenin 409, par. (1) të KPRK-së, në kuptim të nenit 31 të KPRK-së (Pika B.2),
- **Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare**, në kundërshtim me nenin 317, par. (1) të KPK-së, në kuptim të nenit 23 të KPK-së, aktualisht të dënueshme me nenin 410, par. (1) të KPRK-së, në kuptim të nenit 31 të KPRK-së (Pika B.3),

- **Pjesëmarrje në turmën e cila është duke kryer veprën penale**, në kundërshtim me nenin 320, par. (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, aktualisht të dënueshme me nenin 412, par. (1) të KPRK-së, në kuptim të nenit 31 të KPRK-së (Pika B.4),
- **Dëmtim i pasurisë së luajtshme**, në kundërshtim me nenin 260, par. (1) dhe (2), lidhur me nenin 23 të KPK-së, aktualisht të dënueshme me nenin 333, par. (1) dhe (4), në kuptim të nenit 31 të KPRK-së (Pika B.5)

*Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 122/2014 të datës 23 tetor 2015, të shpallur fajtor dhe të dënuar, sipas pikës B të aktakuzës, për këto veprat penale:*

- 1) Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, në kundërshtim me nenin 142, par. (2) të KPK-së, duke e dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim,
- 2) Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në kundërshtim me nenin 316, par. (1) dhe (3) të KPK-së, duke e dënuar me 4 muaj burgim,
- 3) Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në kundërshtim me nenin 317, par. (1) të KPK-së, duke e dënuar me 6 muaj burgim,
- 4) Dëmtimi i pasurisë së luajtshme në kundërshtim me nenin 260, par. (1) të KPK-së, duke e dënuar me gjobë në vlerë prej 700 eurosh.

Po ashtu i shpallur fajtor në mënyrë të ndarë për të njëjtat akte në bashkëkryerje me një të pandehur tjetër si dhe me 18-28 kryerës të tjerë të panjohur dhe një person të identifikuar dhe i dënuar me 1 vit e 6 muaj burgim, me 8 muaj burgim, përkatësisht me 10 muaj burgim dhe me gjobë në vlerë prej 1000 eurosh,

*Dënimi unik është caktuar si dënim me kusht prej 1 vit e 10 muaj burgim, i kushtëzuar për 4 vjet si dhe me gjobë në vlerë prej 1,500 eurosh.*

I urdhëruar të paguajë 150 euro në emër të një pjese të shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa pjesa tjetër duhet të paguhet nga burimet buxhetore;

I liruar nga akuza për Pjesëmarrje në turmën e cila është duke kryer veprën penale, në kundërshtim me nenin 320, par. (1), në kuptim të nenit 23 të KPK-së,

*Duke e shqyrtuar ankesën ndaj aktgjyimit të sipërpërmendur, të bërë nga mbrojtësi Faruk Korenica më 8 shkurt 2016;*

*Duke e pasur parasysh përgjigjen e prokurorit të EULEX-it, të parashtruar më 15 shkurt 2016;*

Duke e pasur parasysh propozimin e Prokurorit të Apelit të Shtetit, të parashtruar në Gjykatën e Apelit më 18 prill 2016;

Pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 15 shtator 2016;

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 15 shtator 2016;

Duke vendosur sipas neneve 389, 390, par. (4), 394, 398, par. (1), pikës 1.1 dhe 1.4, nenit 401 dhe 403 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: KPP),

Sjell këtë:

## **AKTGJYKIM**

**I. Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e mbrojtësit Faruk Korenica, e parashtruar në emër të të akuzuarit B. J. më 8 shkurt 2016 kundër Aktgjyimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 122/2014 të datës 23 tetor 2015; ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 122/2014 i datës 23 tetor 2015:**

- **Akuza Dëmtimi i pasurisë së luajtshme, në kundërshtim me nenin 260, par. (1) të KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 333, par. (1) dhe (4) të KPRK-së dhe e njëjta akuzë në kuptim të nenit 23 të KPK-së, aktualisht sipas nenit 31 të KPRK-së refuzohet në bazë të nenit 363, par. (1), pikës (1.3) të KPP-së, pasi që afati absolut i parashkrimit ka skaduar më datën 3 prill 2016, në pajtim me nenin 90, par. (1), pikën 6) të KPK-së, lidhur me nenin 91, par. (6) të KPK-së;**
- **Pjesa tjetër e ankesës së parashtruar nga mbrojtësi Faruk Korenica, refuzohet si e pabazuar;**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 122/2014 i datës 23 tetor 2015 ndryshohet *ex officio* si në vijim:**

**I akuzuari B.J., i cili është shpallur në mënyrë të ndarë fajtor lidhur me aktet kriminale më 3 prill 2012 rreth orës 11:00 pranë fshatit xxx dhe për aktet kriminale më 3 prill 2012 në mes të orës 11:00 – 12:05 pranë xxx, ka kryer në bashkim dhe në vazhdimësi këto vepra penale:**

- Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, në kundërshtim me nenin 142, par. (3) të KPK-së, e kryer pjesërisht në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK-së dhe e dënuar me 1 vit e 6 muaj burgim,
- Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në kundërshtim me nenin 316, par. (1) dhe (3) të KPK-së, e kryer pjesërisht në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK-së dhe e dënuar me 8 muaj burgim,
- Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në kundërshtim me nenin 317, par. (1) të KPK-së, e kryer pjesërisht në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK-së dhe e dënuar me 10 muaj burgim,

I akuzuari B.J. dënohet me dënim unik prej 1 (një) vit e 10 (dhjetë) muaj burgim, në bazë të nenit 71, par. (2), pikës 2.1 dhe 2.2 të KPK-së, i cili dënim në bazë të nenit 43, par. (2) dhe nenit 44, par. (1) dhe (2) të KPK-së shndërrohet në dënim me kusht për një periudhë verifikuese në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.

**III. Vërtetohet pjesa tjetër e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 122/2014, të datës 23 tetor 2015.**

---

## ARSYETIM

### I. PROCEDURA E GJERTANISHME

Ngjarjet të cilat i kanë paraprirë kësaj çështjeje penale kanë ndodhur më 3 prill 2012 rreth orës 11:00 në fshatin xxx dhe në xxx, ku ka qenë i përfshirë automjeti i EULEX-it Toyota Landcruiser, të vozitur nga polici i EULEX-it Tino Anderson, i cili ishte duke e kryer detyrën e tij zyrtare.

Më 13 mars 2014, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka sjellë vendimin nr. 2014 – OPEJ – 0147 – 0001, të datës 13 mars 2014, me të cilin lënda në fjalë është caktuar nën kompetencën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve të EULEX-it.

Më 23 mars 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka marrë vendimin nr. 23/2015 me të cilin ishte miratuar kërkesa e EULEX-it që të vazhdohet me gjykimin e lëndës P. Nr. 122/14. Në arsyetim shkruan: *“Kërkesa e EULEX-it për t’ia caktuar lëndën në fjalë trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it ka qenë e arsyetuar me urgjencën dhe ndjeshmërinë e lartë të kësaj çështjeje ...”* Më tutje shkruan *“... konfirmon se çështja e përmendur më lart do të gjykohet nga*

*ana e gjyqtarëve të EULEX-it ... dhe se çështja në fjalë konsiderohet si “lëndë në vazhdim e sipër”.*

Përshkrimi i detajuar i procedurës deri në shpalljen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjendet në aktgjykimin e datës 23 tetor 2015.

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **B.J.** më 1 shkurt 2016, ndërsa mbrojtësit të tij Faruk Korenica më 29 janar 2016, kurse prokurorit të EULEX-it më 28 janar 2016. Më 8 shkurt 2016, mbrojtësi Faruk Korenica ka parashtruar ankesën e datës 4 shkurt 2016, në kundërshtim të aktgjykimit në fjalë. Më 15 shkurt 2015, prokurori i EULEX-it ka parashtruar përgjigjen në ankesën e datës 12 shkurt 2016.

Më 14 mars 2016 lënda i është kaluar Gjykatës së Apelit (në vazhdim të tekstit: Gj/A) për vendim rreth ankesës në fjalë. Lënda të njëjtën ditë i është dërguar Prokurorisë së Apelit dhe i është kthyer Prokurorisë së Apelit të Shtetit për propozimin e tij më 18 prill 2016.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit (në vazhdim të tekstit: Kolegji) është mbajtur më 15 shtator 2016 në prani të prokurorit të apelit. Mbrojtësi i të pandehurit, avokati Faruk Korenica është ftuar me kohë siç demonstrohet me fletë dërgesat në shkresat e lëndës, por nuk ka marrë pjesë. Thirrja për seancën e kolegjit i është dërguar me kohë të akuzuarit **B.J.** dhe është kthyer në Gj/A me shënimin ‘person i panjohur’ të shkruar mbi zarf. Kolegji e ka vazhduar seancën në bazë të nenit 390, par. 4 të KPP-së.

Kolegji ka mbajtur këshillimin dhe votimin më 15 shtator 2016.

## **II. PARASHTRESAT E PALËVE**

### Ankesa

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Faruk Korenica ka parashtruar ankesë të afatshme më 4 shkurt 2016, të cilën e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës më 8 shkurt 2016, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të procedurës penale (neni 384, par. (1), nënpar. 1.12 dhe par. (2), nënpar. 2.1 i KPP-së),
- Shkeljes së kodit penal (neni 385, par. (1), nënpar. 1.3 i KPP-së),
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386, par. (1), (2) dhe (3) të KPP-së) si dhe
- Vendimit mbi dënimin (neni 387, par. (1) i KPP-së).

Mbrojtësi pretendon se dispozitivi i aktgjykimit në fjalë është i pakuptueshëm, në masë të madhe kontradiktor me veten dhe me arsyetimin e aktgjykimit, nuk përmban arsyetim lidhur me faktet vendimtare dhe është i paqartë rreth gjendjes së vërtetuar faktike. Pastaj, mungon përshkrimi i veprimeve të **B. J.** lidhur me katër veprat penale. Në tërë aktgjykimin mungon diskutimi se si gjykata e ka vërtetuar ekzistimin e dashjes së të pandehurit dhe cilat janë faktet që e bëjnë atë bashkëkryerës.

Mbrojtësi pretendon se gjykata e ka shkelur nenin 442, par. (4) të KPP-së duke mos e refuzuar aktakuzën e ndryshuar pasi që ajo nuk përmbante asgjë të re krahasuar me aktakuzën fillestare.

Mbrojtësi në fjalë, po ashtu, pretendon se personeli i EULEX-it nuk mund të trajtohet si “personel në marrëdhënie me to”, pasi që kjo shprehje shpjegohet qartë në nenin 142, par. (6), nënpar. (2) të KPK-së.

Ai gjithashtu pohon se është shkelur neni 385, par. (1), nënpar. 1.3 i kodit procedural, pasi që veprat penale nga neni 316 dhe 317 (Pengim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe Sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare) bëjnë pjesë në Ligjin mbi amnistinë nr. 04/L-209 të datës 11/07/2013, prandaj ligji e parandalon ndjekjen penale të tyre.

Ai po ashtu pretendon se aktgjykimi mbështetet në fotografitë e bëra nga policia e EULEX-it pa lejen e gjykatës dhe në raportet policore të cilët nuk duhet të konsiderohen si prova. Gjukata e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për t’i thirrur dhe për t’i marrë në pyetje ushtarët e KFOR-it lidhur me rrethanat nëse **J.** iu ka shkaktuar dëm ndonjë automjeti të EULEX-it. Për më tepër, identifikimi në gjykatë i të pandehurit nga dëshmitarët nuk ka qenë në përputhje me parimet e përcaktuara në KPP.

Nga dispozitivi i aktgjykimit, e vetmja vepër penale gjoja e kryer nga klienti i tij është vepra penale Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe asnjë vepër tjetër penale.

Ai po ashtu pretendon se aktgjykimi i mungojnë edhe tre dispozitivë tjerë të cilët është dashur të shqyrtohen.

Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin duke i refuzuar akuzat sipas nenit 316, par. (1) dhe (3) dhe nenit 317, par. (1) të KPK-së, pasi që amnistia e ndalon ndjekjen penale të tyre. Lidhur me veprat Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, sipas nenit 142, par. (3) të KPK-së, ai propozon lirim të tij sikurse edhe për veprën Dëmtim i pronës së luajtshme, sipas nenit 260, par. (1), pasi që ka skaduar afati absolut i parashkrimit, në bazë të nenit 90, par. (6), në kuptim të nenit 91, par. (6) të KPK-së. Përndryshe, aktgjykimi duhet të anulohet dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore.

## Përgjigjja në ankesë

Prokurori i EULEX-it Pascal Persoons më 15 shkurt 2016 e ka parashtruar përgjigjen e tij, e cila e mban datën 12 shkurt 2016.

Prokurori në fjalë thekson se aktgjykimi – për dallim nga pretendimi i mbrojtësit – i përshkruan në mënyrë të plotë veprimet e kundërligjshme të të pandehurit. Ai parashtron se çështja e dashjes nuk është çështje materiale lidhur me faktet dhe elementet e kryerjes së veprave për të cilat është dënuar i pandehuri në fjalë.

Ai pretendon se kritikën e mbrojtësit në drejtim të aktakuzës dhe aktgjykit janë kritika të gabuara, të pavenda dhe joracionale pasi që mbrojtësi e injoron në tërësi pjesën e arsytimit të aktgjykit lidhur me rolin e detajuar të të pandehurit si dhe arsytimin lidhur me përkufizimin e shprehjes “personel në marrëdhënie me to”.

Për më tepër, veprat për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor nuk bëjnë pjesë në spektrin e atyre veprave penale të përshkruara në nenin 3 të Ligjit mbi amnistinë. Ai e thekson se vlerësimi ndryshe i aktgjykit, i bërë nga mbrojtësi në fjalë është jo-relevant dhe i parëndësishëm për faktet, prandaj në asnjë mënyrë nuk e zbeh fajësinë e të pandehurit në fjalë. Ai po ashtu i refuzon argumentet e mbrojtësit lidhur me pranueshmërinë e fotografive, pasi që ato janë siguruar në mënyrë ligjore dhe janë vërtetuar edhe me prova të tjera siç janë deklaratat e dëshmitarëve dhe raportet e policisë.

Prokurori propozon që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

## Propozimi i Prokurores së Apelit

Prokurorja e Apelit, Anca Stan në propozimin e saj të detajuar të datës 15 prill 2016, të cilin e ka parashtruar në Gjykatën e Apelit më 18 prill 2016, në formë të strukturuar i adreson të gjitha pretendimet e mbrojtësit.

Sa i përket pranueshmërisë së fotografive, ajo thekson se fare nuk ka pasur nevojë për autorizim nga gjykata. Për më tepër, polici në fjalë jo vetëm që i është lejuar bërja e fotografive në fjalë por ka qenë detyrë e tij që t'i regjistrojë të gjitha faktet dhe rrethanat.

Lidhur me pranueshmërinë e raporteve policore, ajo thekson se gjykata ka vepruar në përputhje me nenin 123 (2) të KPP-së.

Kur kemi të bëjmë me pranueshmërinë e identifikimit të të pandehurve në gjykatë, prokurorja e apelit thekson se nuk ka rregulla specifike me të cilat ndalohet identifikimi në gjykatë dhe gjatë

gjithë kohës është respektuar e drejta të pandehurve për gjykim të drejtë, ndërsa dëshmitari e ka bërë të qartë se të pandehurin **B. J.** e kishte njohur vetëm nga fotografitë. Për më tepër, mbrojtja e ka pasur mundësinë e marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë të dëshmitarit në fjalë.

Prokurorja e apelit në propozimin e saj deklaroi se pretendimet e mbrojtësit se gjoja dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban as përshkrim të veprimeve të të pandehurit **B. J.** as referencë ndaj bashkëkryerjes janë pretendime ashiqare të pabazuara, sepse nëse lexohet dispozitivi aty shihet se ekziston edhe përshkrimi i veprimeve edhe referimi nenit 23 të KPK-së.

Ajo thekson se pretendimet e mbrojtjes se dispozitivi nuk tregon se është sulmuar personeli i Kombeve të Bashkuara dhe e përmend vetëm personelin e EULEX-it, ndërsa personeli i EULEX-it nuk mund të konsiderohet si “personel në marrëdhënie me to” janë pretendime të pabazuara, pasi që aktgjykimi në mënyrë të qartë i shpjegon arsyet pse personeli i EULEX-it i përmbush kriteret sipas nenit 142 (6.2.i) të KPK-së. Lidhur me këtë, ajo thirret në nenin 5 të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe në Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CSFP, me të cilin është themeluar EULEX-i.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se aktakuza e ndryshuar është dashur të refuzohet nga gjykata pasi që nuk përmbante asgjë të re, prokurorja e apelit e thekson se i vetmi kusht ka qenë që aktakuza fillestare të prezantohet në një formë më të strukturuar, gjë e cila është plotësuar me aktakuzën e ndryshuar. Sidoqoftë, është Gjykata e Apelit ajo që ka vendosur ta pranojë aktakuzën e ndryshuar në fjalë.

Prokurorja e apelit është e mendimit se për dallim nga argumenti i mbrojtjes, Ligji mbi amnistinë nuk zbatohet lidhur me veprat penale Pengim dhe sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare. Këto vepra amnistohen vetëm po qe se janë “kryer duke synuar kryerjen e veprës penale të thirrjes në rezistencë” në përputhje me nenin 3 (1.1.13, nënpikat 10.11) të Ligjit mbi amnistinë, gjë e cila nuk vlen në rastin në fjalë.

Më tutje, afati i parashkrimit nuk ka skaduar as në rastin e veprës Dëmtim i pronës së luajtshme as në rastin e veprës Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to.

Lidhur me heqjen e pretenduar të tri akuzave, prokurorja e apelit e thekson se Gjykata Themelore i ka gjykuar dhe i ka vendosur të gjitha akuzat e ngritura ndaj të akuzuarit **B.J.**

Ajo gjithashtu e thekson se nuk ka mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsyesimit, siç pretendohet nga mbrojtja. Për më tepër, me aktgjykimin në fjalë është vërtetuar dashja e të akuzuarit.

Gjykata me të drejtë e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për thirrjen në gjykatë të ushtarëve të KFOR-it, pasi që mbrojtja nuk ka arritur ta shpjegojë çfarë rëndësie do të kishin dëshmitë në fjalë.



Ankesa e mbrojtjes lidhur me dënimin duhet të hedhet poshtë si e papranueshme për shkak se ankesa nuk e ka adresuar këtë çështje me asnjë fjalë të vetme, prandaj si e tillë ajo nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me nenin 382 (1), (1.2) dhe 376 të KPP-së.

Prokurorja e Apelit i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ankesën në fjalë.

### III. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT

#### A. Kompetenca e Kolegjit të Gjykatës së Apelit

Palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e kolegjit apo kompetencën e tij. Në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, Kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e vet.

Siç është theksuar më lart, më 23 mars 2015 Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konfirmuar se çështja në fjalë është “lëndë në vazhdim e sipër”. Praktika juridike në Kosovë kishte vendosur interpretimin sipas të cilit lënda që iu ishte caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në shumicë do të vazhdohej të gjykohej me shumicë nga gjyqtarët e EULEX-it gjatë tërë procedurës penale në të gjitha fazat ose në të gjitha instancat gjyqësore deri në nxjerrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo praktikë ka qenë në mënyrë eksplicite e përfshirë në Ligjin e ri mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve lidhur me mandatin e misionit të sundimit të ligjit të Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 05/L-103), neni 3 i të cilit e riformulon nenin 1 A, par. 2 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 – të ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-273, me këto fjalë: *“Për qëllime të këtij ligji, lënda e përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni, do të konsiderohet si lëndë në vazhdim e sipër gjatë zhvillimit të tërë procedurës penale në të gjitha fazat apo instancat gjyqësore deri në nxjerrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke përfshirë këtu edhe shqyrtimin në bazë të mjeteve të jashtëzakonshme juridike.”*

Kolegji konkludon që EULEX-i ka juridiksion mbi lëndën në fjalë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur lidhur me lëndën përkatëse në përbërje prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari kosovar të apelit.

#### B. Pranueshmëria e ankesës

Gjykata Themelore e ka shpallur aktgjykimin më 23 tetor 2015. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar të akuzuarit **B. J.** më 1 shkurt 2016, ndërsa mbrojtësit të tij Faruk Korenica më 29 janar 2016. Kjo ankesë është parashtruar më 8 shkurt 2016, brenda afatit prej 15 ditësh duke filluar nga data kur i pandehuri e ka pranuar aktgjykimin, në përputhje me nenin 478 (4) të KPP-së. Ankesa është po ashtu e pranueshme pasi që është parashtruar nga personi i autorizuar, në bazë të nenit 380 (1) të KPP-së.

### C. Gjetjet mbi çështjet meritore

Pretendimet dhe argumentet e ngritura në ankesë:

1. Pretendimi se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në masë të madhe kundërthënës me veten dhe me arsyetimin e aktgjykimit

Kolegji nuk e mbështet pretendimin në fjalë. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore i përmban të gjitha elementet e domosdoshme të përcaktuara me ligj sipas nenit 384 (1.12), në kuptim të nenit 370 të KPP-së. Ai ofron një përshkrim të qartë të fakteve vendimtare dhe sqarim të veprave penale të kryera me emërtimin ligjor dhe në bazë të të cilave fakte është shqiptuar dënimi.

Aktgjykimi i kundërshtuar në asnjë rast nuk është kundërthënës me veten. Gjykata Themelore ka bërë vlerësim të drejtë të provave në mënyrë individuale dhe për secilin nga të pandehurit si dhe në mënyrë të qartë e ka shpjeguar pjesëmarrjen e saktë të të akuzuarit **B. J.** në veprat penale të ndryshme, të cilat janë objekt i aktakuzës dhe aktgjykimit. Emërtimi i saktë ligjor i veprave penale mbështetet në provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor. Për këtë arsye, kjo bazë ankimore e ankesës refuzohet si e pabazuar.

2. Pretendimi mbi shkeljen e nenit 442, par. (4) të KPP-së pasi që gjykata nuk e ka refuzuar aktakuzën e ndryshuar për shkak se ajo nuk përmbante asgjë të re në krahasim me aktakuzën fillestare

Kolegji gjen se pretendimi i mbrojtjes në këtë drejtim është pretendim i pambështetur. Duke iu referuar nenit 442, par. (4) të KPP-së, kryetari i trupit gjykues ka vepruar drejt në përputhje me nenin e sipërpërmendur kur e ka udhëzuar prokurorin që ta riformulojë Aktakuzën e datës 10 tetor 2014, në kuptimin e prezantimit të “*akuzave në mënyrë të rregullt*”. Duke e respektuar udhëzimin e gjyqtarit, më 14 tetor 2014 prokurori ka ngritur aktakuzë të strukturuar dhe të korigjuar, e cila i përmban pikat për secilin të akuzuar veç e veç ‘*të përshkruara në mënyrë transparente ‘dhe ‘të prezantuara së bashku me cilësimin e tyre përkatës juridik*’, siç theksohet në aktgjykimin e kundërshtuar. Prandaj,

konkludohet se aktakuza e prezantuar i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 241 të KPP-së.

Për më tepër, pranueshmëria e aktakuzës tashmë është diskutuar në detaje nga Gjykata e Apelit më 2 dhe 3 prill 2015 në Aktvendimin e saj PN 79/15, prandaj Kolegji mjaftohet me gjetjet e tyre në këtë Aktvendim.

3. Pretendimi se personeli i EULEX-it nuk mund të trajtohet si “personel në marrëdhënie me to”

Kolegji e refuzon këtë pretendim. Siç është theksuar me të drejtë në Aktgjykimin dhe në propozimin e Prokurorit të Apelit, shprehja e saktë e personelit të OKB-së dhe ‘personelit në marrëdhënie me to’ shpjgohet në mënyrë të qartë në nenin 142 të KPK-së.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, në nenin 5 *‘vendos mbi dërgimin në Kosovë, nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara, të pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, me pajisje dhe personel të duhur sipas nevojës’*.

EULEX-it është themeluar përmes Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, i cili është aprovuar më 4 shkurt 2008 ndërsa vendimi përfundimtar është marrë më 16 shkurt 2008, ku shkruan:

*‘[...] Nga Sekretari i Përgjithshëm / Përfaqësuesi i Lartë (SP/PL) është kërkuar që të përgatisë misionin në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse të Kosovës dhe të Kombeve të Bashkuara. [...] Në këtë drejtim, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara po ashtu ka parë gatishmërinë e BE-së për të luajtur një rol më të madh në Kosovë, siç pasqyrohet në konkluzionet e Këshillit Evropian në Bruksel më 14 dhjetor’.*

Për këtë arsye, nuk mund të ketë asnjë dyshim se personeli i EULEX-it nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 142, par. (6) 2) të KPK-së dhe prandaj ai duhet të konsiderohet si personel në marrëdhënie me to, ashtu siç është vlerësuar drejt nga ana e trupit gjykues.

4. Pretendimi mbi shkeljen e nenit 385, par. (1), nënpar. 1.3 të KPK-së si vepra penale sipas neneve 316 dhe 317 (Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe Sulm ndaj personit zyrtar që është duke kryer detyrat zyrtare) hyn në Ligjin mbi amnistinë nr. 04/L-209 të datës 11/07/2013

Kolegji vëren se Ligji mbi amnistinë nr. 04/L-2009, i datës 11 korrik 2013 iu referohet veprave penale të kryera para datës 20 qershor 2013 (neni 2 i Ligjit nr. 04/L-209), gjë e cila vlen në rastin në fjalë, duke e kufizuar amnistinë vetëm për kryerësit e veprave penale të përmendura në nenin 3 të Ligjit në fjalë dhe vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara me

nenin 3 të të njëjtit ligj. Neni 3 (1.2.8) ofron amnisti për veprën penale Thirrje për rezistencë (neni 319 i KPK-së), kur kryerja e kësaj vepre ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale dhe i njëjti nen më tej i përmend disa vepra penale tjera, kryerësit e të cilave amnistohen vetëm në qoftë se veprat penale janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë. Veprat penale të përcaktuara me nenet 316 dhe 317 të KPK-së përmenden në këtë nen (1.2.8.7 dhe 1.2.8.8.), prandaj, ato vepra amnistohen vetëm nëse janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale **thirrje për rezistencë**, gjë e cila nuk vlen në rastin në fjalë.

Lidhur me thirrjen për rezistencë, neni 319 i KPK-së përcakton:

*'Kushdo që nxit të tjerët me përdorim të dhunës ose me kanosje serioze për të ndaluar ekzekutimin e vendimeve apo masave të ligjshme të lëshuara nga organi kompetent apo zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dënohet me jo më shumë se tri vjet burgim.'*

Neni përkatës 411 i KPRK-së përcakton:

*1. Kushdo që thërret të tjerët për rezistencë apo mosbindje ndaj vendimeve apo masave të ligjshme të nxjerra nga organi apo zyrtari kompetent, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.*

*2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vështirësi të mëdha apo pamundësi të zbatimit të vendimit, masës apo veprimit zyrtar të ligjshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Për shkak të mungesës së komentimit të kodit të vjetër penal të Kosovës, Kolegji i Gjykatës së Apelit i referohet komentimit të kodit të ri penal lidhur me domethënien e **thirrjes për rezistencë**.

Edhe pse dënimi nuk është i njëjtë, elementet e veprës penale të *thirrjen për rezistencë* mbeten të njëjta:

- a) Elementi themelor është thirrja që iu drejtohet të tjerëve për të rezistuar me dhunë ndaj vendimit dhe masave të ligjshme të organit kompetent apo ndaj zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.
- b) Veprimi i thirrjes. Thirrja për rezistencë e drejtuar të tjerëve duhet të provokojë vendimin e të tjerëve për të rezistuar ndaj vendimit dhe masave të ligjshme të organit kompetent apo të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

- c) Rezistenca duhet të jetë ndaj vendimit dhe masave të ligjshme. Zakonisht një thirrje e tillë për rezistencë përdoret *p.sh.* për t'i penguar masat e importit, ndalimin e lëvizjes në vende të caktuara.
- d) Kjo veprë penale kryhet vetëm me qëllimin që përfshin ndërgjegjësimin që thirrja e drejtuar të tjerëve përbën thirrje për rezistencë. Aktori i kësaj veprë penale mund të jetë gjithkush.

Nuk ka kurrfarë prove e cila do të tregonte që **B.J.** i ka filluar trazirat në ndonjë mënyrë apo e ka provokuar vendimin e të tjerëve apo i ka thirrur të tjerët për rezistencë. Në aktakuzë nuk ka pasur një përshkrim të tillë faktik dhe ai nuk është akuzuar lidhur me aktivitetet e tilla. Për këtë arsye, Kolegji e refuzon pretendimin ankimor si të pabazuar.

5. Pretendimi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës mbështetet në fotografitë e marra nga policët e EULEX-it pa leje të gjykatës dhe se raporti i policisë nuk duhet të konsiderohet si provë

Ashtu siç është vërtetuar tashmë nga gjykata e shkallës së parë, veprimet fajësuese të sulmit kanë ndodhur kundër kolonës së departamentit të policisë speciale të EULEX-it. Policët e EULEX-it në këtë kolonë kanë pasur për detyrë të jenë të pranishëm në Portën kufitare nr. 31. Fakti se sulmi është ndërmarrë edhe kundër policëve të cilët po ashtu kanë qenë dëshmitarë të kryerjes së veprës penale, i ka obliguar ata që të veprojnë ashtu sikur policin që është dëshmitar i çfarëdo krimi të kryer. Ashtu siç është theksuar drejt në propozimin e Prokurorit të Apelit, neni 70 (2) i KPP-së i jep policisë të drejtën për t'i hetuar veprat penale dhe për ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshëm për të siguruar sa më shumë prova rreth veprës penale dhe mbledhje të informatave të cilat do të shfrytëzohen gjatë procedurës penale. Pikërisht veprime të këtilla janë ndërmarrë nga policët e EULEX-it duke bërë fotografi të vendit të krimit dhe këto janë të pranueshme në gjykatë.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se raporti policor nuk është dashur të konsiderohet si provë në bazë të dispozitave të KPP-së, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë nuk i ka konsideruar si prova deklaratat e dëshmitarëve të përfshira në këtë raport. Në bazë të rregullave për marrjen e provave, dëshmitarët duhet të dëgjohen drejtpërdrejt rreth fakteve për të cilat kanë qenë dëshmitarë, megjithatë raporti policor është provë dokumentuese e rrethanave të çështjes penale dhe mund të përdoret si e tillë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, siç është vlerësuar drejt nga gjyqtari kryesues gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 27 korrik 2015, siç dokumentohet edhe me procesverbalin e seancës në fjalë. Kolegji vjen në përfundimin se aktgjykimi është i mbështetur vetëm në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Raporti në fjalë është përdorur në pajtim me dispozitat e KPP-së, vetëm me qëllim të testimit të besueshmërisë së deklaratës së dëshmitarit. Kolegji, prandaj, e refuzon pretendimin në fjalë.

6. Gjykata Themelore e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për thirrjen dhe marrjen në pyetje të ushtarëve të KFOR-it lidhur me rrethanat nëse i akuzuari **B.J.** i kishte shkaktuar dëm ndonjë automjeti të EULEX-it

Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur e ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes për ta marrë në pyetje ushtarin e KFOR-it. Zaten, më 8 shtator 2015 gjatë seancës gjyqësore, mbrojtësi ka kërkuar në mënyrë verbale që të thirren ushtarët e KFOR-it pa e specifikuar se çfarë rëndësie ka kjo për çështjen në fjalë. Edhe pse është udhëzuar nga kryetari i trupit gjykues që ta prezantojë propozimin me shkrim lidhur me kërkesën në fjalë, mbrojtësi nuk kishte vepruar kështu. Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me seancat e tjera pa asnjë kundërshtim të parashtruar nga mbrojtësi lidhur me çështjen në fjalë. Duke e konsideruar se mbrojtësi nuk ka sjellë asnjë arsye konkrete e cila do ta lidhte një provë të caktuar me një fakt të caktuar, Kolegji konstaton se refuzimi i bërë nga gjykata e shkallës së parë është i justifikuar. Kolegji nuk e ka parë të domosdoshme që ta caktojë seancën dëgjimore për pranimin e kësaj prove të re, pasi që edhe ashtu akuzat e Dëmtimit të pronës së luajtshme është dashur të refuzohet për shkak të ndalesës absolute të ndjekjes penale.

7. Pretendimi se identifikimi në gjykatë i të pandehurit nga ana e dëshmitarëve nuk ka qenë në pajtim me parimet e përcaktuara në KPP

Dihet se dëshmitë e dëshmitarëve shpesh janë të pasakta dhe të pasigurta për shkak se ato bazohen në perceptime subjektive të cilat iu nënshtrohen ndryshimeve të llojllojshme si pasojë e gabimit, vetëmashtrimit apo sugjerimit. Megjithatë, asnjë prej këtyre nuk vlen në rastin në fjalë. I akuzuari B.J. është identifikuar nga dëshmitari Simon Siegel / polic i EULEX-it, i cili ka rastisur të jetë një prej policëve në kolonën e EULEX-it, kur ajo është sulmuar nga i akuzuari dhe të tjerët. Dëshmitari në fjalë jo vetëm që e ka parë shkurt të akuzuarin **B.J.**, por ka pasur mundësi ta shohë mirë në veprim për më shumë sesa një çast të vetëm dhe bile ka pasur rastin edhe ta fotografojë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 4 shtator 2015, dëshmitari Simon Siegel / polic i EULEX-it ka dëshmuar dhe e ka identifikuar të akuzuarin **B.J.** duke ia përshkruar qartë veshmbathjen dhe veprimet e tij. Identifikimi është bërë nga fotografitë të cilat janë kundërshtuar nga mbrojtësi i të akuzuarit **B.J.**

Duke e pasur parasysh se dëshmitari në fjalë nuk e ka takuar të akuzuarin para apo pas incidentit, është e logjikshme që atij i është dashur t'i referohej fotografisë në mënyrë që ta 'rifreskojë' mendjen. Për më tepër, identifikimi që bazohet në fotografi është i lejuar edhe sipas dispozitave të KPP-së. Neni 120 i KPP-së e njeh '*identifikimin jo të drejtpërdrejtë*' të bazuar në fotografi'. Duke e pasur parasysh se në KPP nuk ka ndonjë dispozitë specifike e cila e ndalon identifikimin në gjykatë në këtë mënyrë, Kolegji konstaton se ky identifikim është bërë pa e shkelur të drejtën

e të pandehurit për gjykim të drejtë. Mbrojtja i ka pasur të gjitha mundësitë gjatë shqyrtimit gjyqësor për t'i parashtruar kundërshtimet e veta.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se parimi i përgjithshëm i vlerësimit të provave duhet të mbështetet në ekzaminimin direkt dhe të menjëhershëm të provave nga ana e kolegjit të gjyqtarëve. Ekzaminimi i dokumenteve dhe provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë gjatë gjyqimit për shkak se ndodh shpesh që këto prova duhet të mbështeten dhe të jenë në përputhje me provat e tjera dhe të jenë objekt i shpjegimeve verbale të dëshmitarëve apo palëve të tjera.

Duke i pasur parasysh këto që u thanë më lart, Kolegji nuk gjen asnjë arsye ligjore për të konsideruar se identifikimi i të akuzuarit nga fotografitë ka qenë i papranueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara me KPP.

8. Pretendimi se vepra penale Dëmtim i pronës së luajtshme sipas nenit 260, par. (1) dhe veprat penale Rrezikim i Kombeve të Bashkuara dhe personelit në marrëdhënie me to, sipas nenit 142, par. (3) të KPK-së, kanë arritur afatin e parashkrimit në bazë të nenit 90, par. (1) 6), në kuptim të nenit 91, par. (6) të KPK-së

Gj/A pajtohet me qëndrimin e mbrojtjes mbi afatin e parashkrimit lidhur me veprën penale Dëmtim i pronës së luajtshme, sipas nenit 260 (1) të KPK-së. Në bazë të nenit 91 të KPK-së, afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon ditën kur është kryer vepra penale. Vepra penale është kryer më 3 prill 2012. Dënimi për këtë vepër penale shkon deri në gjashtë muaj burgim. Për këtë arsye, në bazë të nenit 90, par. (1) 6) të KPK-së, afati i parashkrimit për këtë vepër penale është dy vjet. Është e vërtetë se secili akt i ndërmarë me qëllim të ndjekjes penale e ndërpret afatin e parashkrimit por me ligj përcaktohet ndalesa absolute e ndjekjes penale, që do të thotë se pavarësisht nga veprimet e autoriteteve, ndjekja penale pas atij afati kohor është e ndaluar: neni 91, par. (6) i KPK-së parasheh që: *'Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).'*

Pasi që vepra penale në fjalë është kryer më 3 prill 2012, ndalesa absolute mbi ndjekjen penale është arritur më 3 prill 2016, pra para se Gj/A e ka pranuar propozimin e Prokurorit të Apelit më datën 18 prill 2016.

Për këtë arsye, ndalesa absolute mbi ndjekjen penale ndaj të akuzuarit **B.J.** lidhur me akuzën për Dëmtim të pronës së luajtshme sipas nenit 260, par. (1) të KPK-së ishte arritur para datës kur kolegji i apelit e kishte mbajtur këshillimin për këtë lëndë.

Kolegji e konsideron të pambështetshëm pretendimin e mbrojtësit se vepra penale Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe personelit në marrëdhënie me to, në bazë të nenit 142, par. (3) të KPK-së e ka arritur parashkrimin. Paragrafi (3) i këtij neni parasheh dënimin me

burgim prej një deri në dhjetë vjet. Në bazë të nenit 90, par. (1) 3) të KPK-së, afati i parashkrimit për këtë vepër penale është dhjetë vjet.

Nëse e konsiderojmë datën 3 prill 2012 si datë kur është kryer vepra penale në fjalë, ndalimi i ndjekjes penale nuk e përmbush kushtin e afatit kohor as të ndalesës relative të ndjekjes penale sipas nenit 90, par. (1) 6) të KPK-së. Për këtë arsye, kolegji e refuzon pretendimin në fjalë.

9. Mbrojtësi pretendon se aktgjykimet të kundërshtuar i mungojnë edhe tre (3) dispozitivë tjerë

Pretendimi i mbrojtjes në këtë aspekt është i paqartë. Mbrojtësi nuk sjell asnjë argument për ta mbështetur një pretendim të tillë. Ndaj të akuzuarit **B.J.** është ngritur aktakuza për veprat penale të përshkruara në aktakuzë dhe ai është shpallur fajtor për katër vepra penale të ndara në tetë (8) pika të aktakuzës. Aktgjykimi po ashtu në mënyrë të qartë ka sqaruar se nuk është vërtetuar vepra penale Pjesëmarrje në turmën e cila është duke kryer vepër penale. Nuk ka ndonjë përshkrim faktik në aktakuzë i cili nuk është mbuluar nga aktgjykimi në fjalë. Kolegji i Gjykatës së Apelit prandaj e refuzon këtë pretendim.

10. Çështjet *ex officio*

Kolegji nuk pajtohet me zgjidhjen e gjykatës së shkallës së parë për ndarjen e veprimeve të të akuzuarit **B. J.** në dy grupe të veprave penale, zaten ndaras kur ai ka vepruar individualisht në xxx rreth orës 11:00 më 3 prill 2012 dhe ndaras kur ai ka vepruar në bashkëkryerje me të pandehur të tjerë pranë xxx nja 10 minuta më vonë, rreth orës 11:10-12:05.

Trupi gjykues i shkallës së parë ka konstatuar drejt se ka pasur prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **B. J.** kishte kryer veprat penale Rrezikim i Kombeve të Bashkuara dhe personelit në marrëdhënie me to, Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkim. Megjithatë, kolegji i Gjykatës së Apelit konstaton se në vend të dy pikave të ndara për secilën vepër penale, secila vepër penale e përmendur më lart në bashkim është kryer në vazhdimësi dhe pjesërisht në bashkëkryerje.

Vazhdimësia e akteve kriminale të të akuzuarit **B.J.** rrjedh nga e njëjta ngjarje e cila ka filluar të zhvillohet fillimisht pranë fshatit xxx pastaj në lokacionin afër xxx. Veprat penale janë kryer nga të akuzuar të njëjtë kundër palës së dëmtuar të njëjtë / interesit të mbrojtur të njëjtë brenda një periudhe të shkurtër kohore. Kolegji vëren se për dallim nga KPRK-ja e re, KPK-ja – e cila ka qenë në fuqi kur aktet në fjalë janë kryer dhe është zbatuar me të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë – nuk përmban asnjë dispozitë ligjore kur veprat penale duhet të konsiderohen si vepra të kryera në vazhdimësi. Megjithatë, në teorinë dhe praktikën ligjore është zbatuar kjo zgjidhje që është më e favorshme për të pandehurin në kohën kur në fuqi ka qenë KPK e po ashtu edhe sipas Kodit Penal të Jugosllavisë (KPRSFJ). Në lëndën penale në fjalë plotësohen kushtet për të konsideruar se jo dy vepra penale të ndara por vetëm një vepër penale në



vazhdimësi ka ndodhur. I akuzuari ka kryer saktësisht të njëjtat vepra penale në të dyja lokacionet brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe kundër palës së njëjtë të dëmtuar / interesit të mbrojtur. Duke e pasur parasysh këtë, kolegji konstaton se këto akte kriminale duhet të konsiderohen si vepra penale në bashkim real fiktiv, të kryera në vazhdimësi dhe pjesërisht në bashkëkryerje, siç specifikohet në dispozitiv.

Për shkak të ndryshimeve të përmendura më lart, kolegji ka lënë mënjanë grupin e parë të dënimeve individuale të cilat janë shqiptuar ndaras për veprat penale të kryera në Zupce si dhe gjobat e shqiptuara për shkak të parashkrimit absolut të veprave penale për të cilat ishin shqiptuar gjobat në fjalë. Në të njëjtën kohë, kolegji ka konstatuar se dënimet e shqiptuara individuale të grupit të dytë të dënimeve për veprat penale të kryera afër Zubin Potokut, si dhe dënimi unik (pa gjobë) i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë janë brenda kufijve të përcaktuar me ligj, duke i pasqyruar rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të çështjes në fjalë dhe duke e përmbushur qëllimin e dyfishtë të dënimit, siç përcaktohet me nenin 34 të KPK-së dhe në pajtim me nenin 71 të KPK-së mbi dënimin e veprave penale në bashkim.

## 11. Çështjet e tjera

Kolegji ka refuzuar akuzën Dëmtim i pronës së luajtshme për shkak të skadimit të afatit absolut të parashkrimit. Duhet të theksohet se në bazë të parimit *beneficium cohaesionis*, të shprehur në nenin 419 të KPK-së, kolegji është dashur të refuzojë të njëjtën akuzë po ashtu edhe për të akuzuarin S.S. Përkundër kësaj, kolegji thekson se Aktgjykimi P. Nr. 122/2014 i datës 23 tetor 2015 ka marrë formë të prerë për të akuzuarin S.S. 15 ditë pasi ai e kishte pranuar Aktgjykimin më 1 shkurt 2016, ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur tek më datën 3 prill 2016, që do të thotë pasi Aktgjykimi kishte marrë formën e prerë për të akuzuarin S. Për këtë arsye, duke qenë të detyruar nga rrethanat e lëndës në fjalë, kolegji do të mjaftohet duke mos vendosur lidhur me këtë çështje lidhur me të akuzuarin S.S.

Siç është thënë më lart, në bazë të nenit 401 të KPP-së dhe nenit 403 të KPP-së, Gjykata e Apelit vendos si në dispozitiv.

*Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze.*

**Kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese**

---

Hajnalka Veronika Karpati, gjyqtare e EULEX-it

**Anëtarë të kolegjit**

---

Radostin Petrov, gjyqtar i EULEX-it

---

Abdullah Ahmeti, gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

**Procesmbajtëse**

---

Vjollca Gërxhaliu-Kroçi, këshilltare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR Nr. 161/15**  
**15 shtator 2016**